



Angazhimi i studentëve në  
punën kërkimore-shkencore

Të drejtat e autorit© 2020. Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM)

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përveç citimeve të pasazheve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të rikthimit të të dhënave, ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti, elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar ose tjetër, pa lejen paraprake të QHPSM.

Përgatitur nga:

Qendra për Hulumtime Psiko-Sociale dhe Mjekësore (QHPSM)

# Angazhimi i studentëve në punë kërkimore-shkencore

Prishtinë, Kosovë

Janar 2020

# PËRMBAJTJA

Hyrje .....	5
Qëllimi .....	6
Metodologjia.....	6
Mostra .....	7
Rezultatet.....	8
Diskutim .....	16
Rekomandime.....	17

# HYRJE

Hulumtimet e bëra me qëllim të kontributit drejt shkencës me anë të mbledhjes sistematike, interpretimit dhe vlerësimit të të dhënave dhe që, gjithashtu, bëhet në një mënyrë të planifikuar quhet hulumtim shkencor. (Çaparlar & Dönmez, 2016).

Rekomandohet të gjenerohen strategji që rrisin prodhimin shkencor, promovojnë dhe stimulojnë fazat e kërkimit, që lejojnë kohë për të gjeneruar njohuri të reja ose për të rritur ato të mëparshme, si dhe përvetësimin e mjeteve të nevojshme metodologjike. Me rritjen e këtij indikator, gjithashtu do të rritet rangimi i universitetit dhe të bashkësia shkencore, duke pasur fitime jo vetëm për subjektet në fjalë, por edhe për formimin e studentit, pasi gjeneron

përvetësim, njohje dhe mbizotërim intelektual në një linjë. Kjo arrihet përmes krijimit të revistave të studentëve që shpërndajnë prodhime shkencore të bëra në diciplina të ndryshme, dhe duke promovuar arsimimin e vazhdueshëm e duke mbështetur rritjen shkencore. (Castellanos & González, 2017).

Përvoja universitare është pasuruar shumë duke arritur përvojë kërkimore që në fillim dhe shpesh. Ka përfitime të shumta për studentët universitar që përfshihen në kërkime shkencore. Përvoja në hulumtime lejon studentët universitar të kuptojnë më mirë veprat e botuara, të mësojnë të balancojnë punën bashkëpunuese dhe individuale, të përcaktojnë një zonë interesi dhe të fillojnë karrierën e tyre si studiues. (Madan, 2012).

## QËLLIMI


Qëllimi i hulumtimit është për të parë interesimin e studentëve për angazhim në hulumtime kërkimore-shkencore në të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, qofshin ato kolegje private apo universitete publike.

## METODOLOGJIA

Ky raport është hartuar bazuar në mbledhjen e të dhënave nga pyetësi i shperndarë online, me metodë kuantitative. Kjo matje është realizuar nga dhjetori i 2019 deri në janar 2020. Përveç këtyre të dhënave QHPSM është shërbyer edhe nga burime tjera kredibile të cilat janë cituar brenda këtij raporti.

# MOSTRA

Respodent nga i gjithë territori i Kosovës, nga vite dhe nivele të ndryshme të studimeve ku më shumë prej tyre janë nga institucione private të arsimit të lartë 1,159 (83.1%) dhe pjesa tjetër, 235 (16.9%) student nga institucione publike të arsimit të lartë.




# REZULTATET

Rezultatet tregojnë se pjesëmarrje më të lartë në këtë pyetësorë kanë studentët e vitit të parë (42.1%) dhe vitit të dytë (27.2%) të nivelit baçelor

Në pyetjen e parashtruar “Përpos hulumtimeve shkencore të domosdoshme për detyrat e fakultetit apo temën e diplomës, a keni realizuar ndonjë hulumtim shkencor gjatë viteve të studimeve?”, 62.1% e studentëve janë shprehur se asnjëherë nuk kanë bërë hulumtime të tilla, 21.4% deklarojnë se vetëm një (1) herë kanë realizuar hulumtime shkencore, 9.5% prej tyre kanë realizuar hulumtime shkencore më shumë se tri (3) herë dhe vetëm 7% kanë realizuar dy (2) herë hulumtime.


Sa herë keni realizuar hulumtime shkencore përveç atyre të detyrueshme?






Në anën tjetër, sipas hulumtimit studentët nuk kanë shumë vetëbesim që të realizojnë hulumtime shkencore në mënyrë të pavarur, pa ndihmën e mësimitdhënësit. Nga 1,394 studentë, më shumë se gjysma (59.1%) asnjëherë nuk kanë realizuar hulumtim shkencor në mënyrë të pavarur, 22.5% kanë realizuar vetëm një (1) herë, 7.7% dy (2) herë dhe 10.6% e tyre kanë realizuar më shumë se tri (3) herë hulumtim pa ndihmën e mësimitdhënësve.

Sa herë keni realizuar hulumtime shkencore në mënyrë të pavarur?



Në vijim, hulumtimi vë gjithashtu në pah vullnetin e studentëve për të bashkëpunuar me të tjerët, përkatësisht kolegët e tyre nga departamenti apo fakulteti tjetër, për të realizuar hulumtime shkencore. Sikurse në pyetjet paraprake, gjendja është pothuajse e ngjashme, ku 60.5% e studentëve kanë deklaruar se asnjëherë nuk kanë bashkëpunuar me kolegë nga departamenti apo fakulteti tjetër për të realizuar ndonjë hulumtim shkencor, 17.9% e tyre kanë bashkëpunuar një (1) herë, 4.4% dy (2) herë, dhe 17.2% e tyre më shumë se tri (3) herë.


Sa herë keni realizuar hulumtime shkencore me kolegë nga departamenti apo fakulteti tjetër?



Vlen të theksohet se për dallim nga pyetjet e kaluara, studentët në institucionet publike janë më të interesuar të realizojnë hulumtime shkencore në bashkëpunim me kolegë nga departamenti apo fakulteti tjetër.

Hulumtimi gjithashtu vë në pah nëse studentët kosovar janë të interesuar për të lexuar hulumtime shkencore të realizuara në Kosovë. Në pyetjen e parashtruar “Kur është hera e fundit që keni lexuar ndonjë hulumtim shkencor të realizuar në Kosovë?”, 33.9% janë shprehur që kanë lexuar brenda këtij muaji, 31.1% në 6 mujorin e kaluar, 20.2% asnjëherë nuk kanë lexuar hulumtim shkencor të realizuar në Kosovë, 8.8% në 12 muajt e kaluar dhe 6.1% në dy (2) vitet e kaluara.


Kur keni lexuar ndonjë hulumtim shkencor të realizuar në Kosovë?



Për të kuptuar më shumë interesat e studentëve karshi hulumtimeve shkencore, është bërë një analizë e ndërthurur ndërmjet pyetjeve “Sa herë keni realizuar hulumtime shkencore përveç atyre të detyrueshme” dhe “Kur keni lexuar ndonjë hulumtim shkencor të realizuar në Kosovë?”.


Nga studentët të cilët kanë realizuar vetëm një (1) hulumtim shkencor, 39.9% e tyre kanë lexuar hulumtime të tjera shkencore në 6 muajt e fundit, 37.6% prej tyre në muajin e fundit, 8.4% në 12 muajt e fundit, 4% në dy (2) vitet e fundit, derisa 11.1% e tyre nuk kanë lexuar asnjëherë hulumtime të tjera shkencore të realizuara në Kosovë.

Kur keni lexuar herën e fundit hulumtim shkencor të realizuar në Kosovë?  
(studentët që kanë realizuar hulumtim shkencorë 1 herë)




Ndërsa, studentët që kanë realizuar dy (2) hulumtime shkencore kanë më shumë prirje për të lexuar hulumtime të tjera shkencore të realizuara në Kosovë. Nga studentët e intervistuar, 45.9% e tyre janë deklaruar se kanë lexuar brenda këtij muaji, 36.7% e tyre në 6 muajt e kaluar, 7.1% në 12 muajt e kaluar, 5.1% në dy (2) vitet e kaluara, dhe 5.1% e tyre nuk kanë lexuar asnjëherë hulumtime shkencore të tjera të realizuara në Kosovë.

Kur keni lexuar herën e fundit hulumtim shkencor të realizuar në Kosovë?  
*(studentët që kanë realizuar hulumtim shkencorë 2 herë)*



Derisa, studentët që kanë realizuar tre (3) apo më shumë hulumtime shkencore përveç atyre të detyrueshme kanë më shumë tendencë për të lexuar hulumtime të tjera shkencore të realizuara në Kosovë. Prej këtij grupi të studentëve, 52.6% kanë deklaruar se kanë lexuar hulumtime shkencore të realizuara në Kosovë brenda këtij muaji, 26.3% në 6 muajt e kaluar, 7.5% në 12 muajt e kaluar, 5.3% në dy (2) vitet e kaluara, ndërsa 8.3% e tyre nuk kanë lexuar asnjëherë hulumtime të tjera shkencore të realizuara në Kosovë.

Kur keni lexuar herën e fundit hulumtim shkencor të realizuar në Kosovë?  
*(studentët që kanë realizuar hulumtim shkencorë 3+ herë)*



Këta studentë, saktësisht 86.8% e tyre deklarojnë se asnjëherë nuk kanë prezantuar punimet e tyre akademike në konferenca shkencore, ndërsa sipas hulumtimit del se 64% e studentëve asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në ndonjë konferencë të tillë për të dëgjuar prezantimet e hulumtimeve shkencore të të tjerëve.

Një prej qëllimeve të këtij pyetësi është të pasqyrojë se sa janë të motivuar studentët që të realizojnë hulumtime shkencore, ku nga 1,394 respondentët 481 apo 34.5% janë shprehur që janë jashtëzakonisht shumë të motivuar për realizimin e hulumtimeve ndërsa 94 nga ta apo 6.7% nuk janë aspak të motivuar

## DISKUTIM

Rëndësia e hulumtimit shkencor është shumë e madhe sepse ngërthen në vete edhe vëzhgime përveç se njohuri e të dhëna që ndihmojnë për të zgjidhur problemet, duke shpikur zgjidhje apo duke zhvilluar produkte të reja. Është e rëndësishme që kërkimi shkencor të zhvillohet në vende të ndryshme e sidomos në Kosovë, kur e kemi të qartë se është një praktikë jo shumë e zhvilluar dhe sepse hulumtimet që janë bërë në vende tjera jo gjithmonë mund të jenë të zbatueshme te ne duke pasur parasyshë kontekstin shoqëror dhe nevojat e njerëzve.

Gjithashtu ky hulumtim tregon që është e rëndësishme të vihen në fokus për të

vënë në praktikë hulumtimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë.

Rezultatet na bëjnë të qartë që studentët, saktësisht 62.1% prej tyre përveç hulumtimeve për të cilat vlerësohen përgjatë studimeve nuk kanë realizuar hulumtime tjera shkencore. Rezultate të ngjajshme kemi edhe në aspektin e bashkëpunimit ku 71.3% deklarojnë që nuk kanë bashkëpunuar asnjëherë me studentë të tjerë dhe 86.8% asnjëherë nuk kanë prezantuar punën e tyre shkencore.

Investimi në kërkim shkencor u lejon studentëve të thellojnë njohuritë e tyre, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në konferenca e publikimet në revista.



# REKOMANDIME

- › Institucionet shtetërore duhet të integrojnë në programet e kurrikulës arsimore proceset e kërkimit shkencor në të gjitha institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë akademike, për të nxitur kështu vetëdijen e stafit të fakulteteve dhe studentëve për rëndësinë e hulumtimit, brenda dhe jashtë viteve të studimit.
- › Krijimi i qendrave brenda universiteteve publike dhe kolegjeve private për kryerjen e procesit të hulumtimit, mund të sigurojë një mundësi të vlefshme për studentët për të sqaruar natyrën e praktikave të kërkimit.
- › Përfshirja e studentëve në hulumtimet shkencore që realizojnë OJQ-të, do të ishte një mundësi e mirë për ta që të kenë qasje praktike në të gjithë procesin e kërkimit shkencor dhe bashkëpunim me të tjerët, gjithashtu njohje mbi fushat e interesit.
- › Mbajtja e trajnimeve që ofrojnë njohuri teorike dhe praktike për qasjet në metodat e fundit kërkimore shkencore, për natyrën e fakteve, për të dhënat dhe mbledhjen e tyre dhe të qenurit kritik ndaj hulumtimeve.
- › Stimulimi financiar dhe sfidimi i studentëve nga universiteti, për të bërë përpjekje dhe për të menduar më lart që të realizojnë hulumtime shkencore përtej asaj që kërkohet në studime.

